



REPUBLIKA E KOSOVËS
REPUBLIC OF KOSOVO
REPUBLIKA KOSOVA



KOMUNA E PEJËS / MUNICIPALITY OF PEJA / OPŠTINA PEĆ

KUVENDI I KOMUNËS PEJË

Numër: 01-060/01-41592

Pejë, datë: 29 Qershor 2026

PROCESVERBAL

Nga takimi i –V- të i rregulltë i Kuvendit Komunal Pejë, i mbajtur me: **29 qershor 2026** me fillim në orën 10:00 h.

Takimi u mbajt në sallën e Kuvendit të Komunës së Pejës.

Në takim prezantojnë: përpos anëtarëve të kuvendit të komunës, kryetari i komunës z. Gazmend Muhaxheri, nënkryetari z. Fatmir Asllani; kryesuesi z. Rexhep Kurtbogaj; drejtorët e SHCK-së, z. Avni Gashi, udhëheqës i sektorit të kuvendit, zyrtare administrative znj. Donjeta Morina: përfaqësues të ZIP-it, përfaqësuesit të OJQ-ve dhe përfaqësues të mediave të shkruara dhe elektronike.

Në vazhdim takimin e kryesoi; kryesuesi z. Rexhep Kurtbogaj, ku e hapi diskutimin për rendin e ditës dhe i sqaroi pikat të cilat janë vendosur në rend dite, pastaj konstatoi se janë 32 anëtarë prezent.

Para se të kalojë te rendi i ditës një informatë rreth funksionimit të pajisjeve, disa pajisje nuk janë duke funksionuar. Kështu që për të gjithë anëtarët që janë prezent po e zgjedhim opsionin për votim me ngritje dore për shkak se ka shumë pajisje që nuk janë duke funksionu dhe mos t' thirr me emra ata që nuk funksionon ajo pajisje. Ndërsa për ata që nuk bën zërimin munden me shfrytëzuar edhe foltoren për prononcimet e tyre.

Z. Drin Veselaj: Kisha kërku që para se të aprovohet rendi i ditës, nese më lejohet që ta lexoj një kërkesë të cilën e kam e që besoj që është rëndësie të veçantë. Nëse më lejohet ju kisha falenderuar për zemërsisht. Të nderuar asamblistë, ne si banorë, miq dhe bashkëqytetarë të heroit të Kosovës, Armend Kukleci, paraqesim këtë kërkesë për vendosjen e bustit dhe emërtimin e parkut të sheshit në emrin e tij. Si shenjë nderimi, respekti dhe mirënjohje e përhershme për jetën dhe veprën dhe sakrificën e tij sublime për lirinë e Kosovës. Një biografi e shkurtë. Armend Kukleci u lind më 1 tetor 1975 në Pejë, shkollën fillore dhe të mesme kreu në Pejë duke vazhduar në studimet në Universitetin e Prishtinës në gjuhën angleze. Armendi u rrit në këtë lagje mes njerëzve që e njohën nga afër për karakterin dhe edukatën e tij dhe vlerat e tij njerëzore kombëtare. Që në moshë të re ai u dallua për fisnikëri, guxim, ndershmëri, dhe dashuri të pakushtëzuar për vendin e tij. Në kohën kur atdheu kishte nevojë më së shumti për bijtë e tij,

Armendi iu bashku luftës çlirimtare në radhët e njësisë për intervenime të shpejta shqiptonja të zeza. Ai ishte njëri ndër luftëtarët e parë të këtij njësi që ra heroikisht në altarin e lirisë duke u bërë simbol i sakrificës dhe i përkushtimit për lirinë e Kosovës. Armendi në luftë njihej ndryshe edhe si pejani. Për veprën dhe sakrificën e tij, Armend Kukleci zë vend të merituar në historinë e lavdishme të popullit tonë dhe mbetet përjetësisht heroj i Kosovës. Emri i tij i cili frymëzon brezat që vijnë pas. Arsytimi i kërkesës vendosja e bustit dhe emërtimi i parkut në emrin e heroit të Kosovës, Armend Kukleci do të përbënte një akt të merituar institucional dhe qytetar për ruajtjen e kujtimit të tij dhe vlerat të cilat ai dha jetën. Kjo iniciativë do të ishte e rëndësishme së veçantë sepse nderon sakrificën e një heroit të Kosovës që dha jetën për lirinë e atdheut. Përkujton faktin se Armendi u lind dhe u rrit pikërisht në këtë lagje duke bërë lidhjen e tij me këtë hapësirë të natyrshme dhe të përherëshme. Ruan dhe përcjell tek brezat e rinj kujtesën historike dhe vlerat e luftës për liri. Përbëson kontributin e njërit prej luftëtarëve të parë e të dalluar të njësit për intervenime të shpejta shqiptonjat e zeza e që ra heroikisht e përjetësisht në altarin e lirisë. Forcon identitetin, krenarinë dhe ndërgjegjen qytetare të komunitetit tonë. Krijon një hapësirë publike që do të shërbejë si vend kujtese, respekti e frymëzimi për gjeneratat e ardhshme. Për ne që e njohim Armendin, kjo kërkesë do të ketë një domethënie shumë të veçantë. Ai nuk ishte vetëm një bashkëqytetar i yni, por ishte një njeri që me karakterin, sjelljen e shembullin e tij ndikoi te gjenerata të tëra. Edhe edhe pse shumë prej nesh kishim dallime në moshë, ai ishte udhërefyës për të gjithë ne, duke na mësuar shembullin e tij për vlerën dhe guximin që ai e kishte për atdheun. Prandaj vendosja e bustit dhe emërtimi i parkut në emrin e tij, në lagjen ku u lind dhe u rrit, përbën jo vetëm nderim të merituar, por dhe një obligim moral qytetar ndaj figurës së tij. Besojmë se nuk ka nderim më të merituar për këtë lagje sesa të mbajë emrin e birit të saj të lavdishëm, heroit e Kosovës, Armend Kukleci, i cili nga këto rrugë u nis drejt pavdekësisë. Prandaj kërkojmë nga komuna e Pejës, nga drejtoritë relevante që ta mbështesë këtë iniciativë dhe të realizojmë që në mënyrë që emri i tij dhe vepra e heroit Armend Kukleci të mbetet përherë pjesë e kujtesës sonë kolektive dhe historisë tonë të lavdishme.

Z.Ardit Berisha: atëherë i nderuar kryesuesi i Kuvendit, të nderuar kolegë asambleistë qëndrojmë pranë kërkesës tonë për futjen e rendit të ditës çështjen e fermerëve të komunës së Pejës dhe miratimit të kërkesës sonë prej 0.10 cent litr të qumështit për fermerët tanë. Siç e dimë ata janë në një gjendje jashtëzakonisht të keqe dhe mbështetja e komunës duhet të ekzistojë. Prandaj kërkoj që në emër të lëvizjes Vetëvendosje të hyjë si rende dite pika gjendja e fermerëve në komunën e Pejës si dhe mbështetja me 0.10 cent për qumësht nga ana e komunës.

Z.Arben Morina: besoj kolegu im e din se jemi duke e bërë maksimumin me mjete, me traktora, me kanale të ujitjes me të gjitha. Mirë kishte me qenë me bërë thirrje qeveritare për me ndalë qumështin mos me hy prej Serbisë, e mos me ju bërë favor Serbisë ne edhe me shku 10 cent qysh ka qenë prej qeverie këto pagesa, këto të tjerat që bëhen komunale jem ka i kryer pak më shumë. Unë e besoj kështu se jam bujk vetë edhe e kam plot shtallë, po nuk i lyp në komunë po i lyp në qeveri le ta ndal qumështin prej Serbisë pastaj bëhen gjithë një zëri. Jemi duke i përkrah bujqit me mjete bujqësore, traktora, mjellëse, kanalle të ujitjes edhe hala më shumë kemi me kanë favor si komunë.

Z.Ardit Berisha: unë kolegë, kërkesa jonë si e lëvizje Vetëvendosje është që kjo pikë të hyjë në rendin e ditës. Sot ka qenë kërkesë edhe herën e kaluar që kjo pikë të hyjë në rendin e ditës. Kryetari i komunës e ka lidhur këtë çështje si politike dhe ka menduar që ne për shkak të

fushatës po e kërkojmë këtë pikë të hyjnë në radin e ditës. Ndërsa sot nuk kemi kohë fushate kjo çështje ka përfunduar domethënë nivelin nacional ndërsa sot po i kthehemi kuvendit komunal edhe komunës. Qeveria e Kosovës dhe Ministria e Bujqësisë i ka marrë të gjitha masat për ndalimin e importit të qumështit edhe qumështit të pluhur. Janë vendosur arkeiza në kanë jemi marrë disa vendime të kjo çështje ndërsa edhe për litjet e qumështit Ministria e Bujqësisë i përkrah bujqit me sa e din me 0.7 cent për klasën e parë të qumështit dhe me klasat e tjera. Edhe në komunat si Lëvizje të gjitha komunat ne i mbështesim fermerët tanë për ritjet e qumështit, ndërsa, kërkesa është e qartë që edhe komuna në këtë rast të fillojë subvencionimin edhe mbështetjen bile qoftë edhe përkohësisht derisa fermerët tanë ta tejkalojnë këtë situatë e cila është jashtëzakonisht e vështirë. Është mirë kur kur të folësh me fol me shifra edhe me zyrtarisht me të hyra nga dogana e Kosovës. Duhet me me fol me saktësi për shkak se nuk hyn shumë prej Serbie kjo nuk është e vërtetë. Ndërsa prapë qëndrojmë pranë asaj kërkesës sonë që kjo çështje të diskutohet. Mendoj që qeverisja juaj bashkë me qeverisjen e PDK-së e ka për obligim që ta përkrah këtë iniciativë sepse duhet t'i qëndrojmë pranë fermerëve tanë. Ndërsa nëse kjo çështje nuk hyn në rendin e ditës, atëherë kjo i bjen që komuna nuk po i përkrah bujqit edhe fermerët tanë.

Z.Tahir Shala: sa i përket temës që po ngrit i nderuari këtu, duhet me sqaruar më së pari anën ligjore. Herën e kaluar pse e kemi shty pikërisht është kjo. Nuk është ajo që kemi dashur me bë politikë. Ti je asambleist i ri ju më së pari duheni me ditë qysh shkon procedura buxhetore që tash si asambleist, je në KPF, të vijnë letrat prej fillimit tash është KABI. Ndërkohë është diskutimi i parë, i dytë, derisa të miratohet ky buxheti komunal edhe shkon edhe merr verdiktin final në qeveri bashkë me buxhetin qëndror. Çka kemi bërë ne si komunë që tash është që në Kab e kemi dyfishuar plus 200.000 euro, e kemi pas 500.000 euro subvencione e kam propozuar bashkë me kryetarin 1.2 milion kanë me qenë veç për subvencione. Subvencioni që kjo paguhet prej subvencionit, jo prej kapitale siç e din edhe ti që komuna ka mjete të mjaftueshme të subvencionit jemi të kufizuar se është e përcaktuar me numër të banorëve s'mundem me ndryshu. Në çdo vit e rritim në bazë të mundësive. Po du me ta shpejgu kronologjinë qysh shkon subvencionet i kemi rrit 1.2 milion për vitin e ardhshëm, se ne e miratojmë buxhetin sivjet për vitin e ardhshëm. A e din qysh shkon mënyra e buxhetit sivjet për vitin e ardhshëm me u implementu veç duhet me ditë sende. Tjetra unë e kam diskutu shumë herë edhe me ana e grupit e di që disa komuna e përkrahin qumështin, vetë jam kanë takim me ministrin u ngrit që kjo çështje një produkt me u subvencionu dy herë nga njëjti burim që konkretisht i bjen buxheti i Kosovës. Një buxhet është si i komunës, si qeverisë, një buxhet është. Auditori i bendshëm i Ministrisë së bujqësisë na ka thënë nuk bën. Atëherë çfarë kemi bërë ne si komunë? E kemi drejtu buxhetin nga mjetet bujqësore. Unë kam qenë në takim vetë me krejt drejtorat të departamentit që ka ministria e bujqësisë, me krejt kolegë, drejt të nivelit republikan që kjo është duhet me e kqyr anën ligjore edhe njëherë. Tash ne jemi në fazën fillestare të miratimit të buxhetit edhe deri në qershor e diskutojmë prapë edhe kqyrim çfarë vendimi mundem me marrë. Vendim ligjor gjithmonë nuk mundesh sot me shti në rend dite edhe me thënë po e miratojmë se je jashtë ligjores asnjë cent s'mundesh me jep se s'ke për këtë vit. Kontrata lidhet sot 700.000€ euro që janë 65 traktorë i kemi përkrahur me mjedra në janar buxheti vjet për subvencione në bujqësi është i harxhuar. Tek kapitalet edhe ato i kemi kontraktuar krejt veç duhesh me ditë qysh funksionon buxheti i komunës edhe i Republikës janë njëjtat procedura.

Z.Naim Bytyqi: kryesues po të drejtohem ne a kemi në komitet për politikë dhe financa çka folëm aty a ke harruar që e ke fjalën për këtë pikë. Nëse legjislacionin e ka në rregull ky për me fut atë

pikë se unë s'po du me mbrojt asnjë grupin e LVV. Nëse ky ka të drejtë me kërkua me u fut ajo pikë rendit të ditës, e ka rregullu materialin, a i pranohet a nuk i pranohet? E tani hymë në debat qashtu qysh folen tonë edhe drejtori. Nuk është si një pjesë e madhe e fjalëve që i tha drejtori që s'ka të drejtë. Ka të drejtë veç duhet me fol të vendoset në pikë. A ka të drejtë me shti ky në pikë atë a jo? A e ka kupton kryesues? Ka mundësi se dhe drejtori çfarë po thotë ka me të drejtë një pjesë të madhe, për shkak të buxhetit e krejt ato diskutohen gjatë kur të vendosen në pikë të rendit të ditës. O ka të drejtë me vendos pikë të rendit të ditës o nuk ka të drejtë, nëse s'keni nevojë me u friksu me hy në rend të ditës. Nëse ky nuk ka arritur me na bindur neve nuk i merr votat. Nëse ka arritur me na bind i merr votat. Shumë e thjeshtë është e keni komplikua, po na dekoncentroni krejt në seancën e kaluar.

Kryesuesi Rexhep Kurtbogaj: unë j'a sqarova propozuesit arsyen pse nuk hyn si rend dite për shkak se nuk i plotëson kushtet në bazë rregullores punës së kuvendit. Edhe në këtë rast unë j'a sugjerova Arditi qysh mundet me hy një pikë rend në dite me i plotësu këto kritere në bazë të rregullores edhe mundet me u propozu si pikë e rendit të ditës. Mirëpo në këtë rast apet sipas rregullores dhe procedurave që janë anëtar i kuvendit duhet me çu propozimin me shkrim, e me çu materialin edhe me i sqaru për krejt anëtarët e kuvendit paraprakisht para se me qenë temë e rendit të ditës me qenë të përgatitur, dhe me dit për çfarë çështje duhet me u diskutu. Në këtë rast Arditi e propozoi apet si pikë e rendit të ditës, por sipas kushteve që duhet me u plotësu, nuk është pikë që mundet me u propozu për rend ditës se nuk janë plotësuar kushtet paraprakisht. Ne veç propozimin e tij veç e diskutuam si pikë të rendit të ditës se u implikuam edhe anëtarët edhe drejtori edhe krejt i dhanë arsyet e veta për me qenë pjesë e si diskutim i rendit të ditës

Nga të gjithë anëtarët prezent me 20 votë pro, 12 anëtar nuk kanë marrë pjesë në votim, u miratua ky rend dite me propozimin që u dha nga kryesuesi:

REND DITE

1. Aprovimi i rendit të ditës.
2. Shqyrtimi dhe miratimi i Procesverbalit të Kuvendit të Komunës së Pejës dt. 29.05.2026.
3. Rishqyrtimi i Vendimit Nr. 24/2026 për fillimin e procedurës për ndryshimin dhe plotësimin e Hartës Zonale të Komunës së Pejës, 2023-2031, sipas kërkesës së MMPH, me nr. prot. 2356-2/26, dt. 28.05.2026.
4. Rishqyrtimi i Vendim Nr. 62 -2025 - Planit Ndërkomunal për Menaxhimin e Integruar të Mbeturinave (PNMIM) 2025 – 2035, në bazë të kërkesës së MMPH për rishqyrtim, me nr. prot: 7271-2/25, dt. 21.10.2025.
5. Shqyrtimi dhe aprovimi i Kornizës Afatmesme Buxhetore 2027-2029.
6. Shqyrtimi dhe miratimi i propozimit të DÇPJ dhe Kryetarit të Komunës për miratimin paraprak të draft - vendimit për dhënie në shfrytëzim afat shkurtër të pronës së paluajtshme Komunale - dy sportele për aktivitete bankare.
7. Shqyrtimi dhe miratimi i propozimit të DÇPJ dhe Kryetarit të Komunës për formimin e komisionit vlerësues për zbatimin e procedurave të dhënies në shfrytëzim afat shkurtër të pronës së paluajtshme Komunale - dy sportele për aktivitete bankare.

8. Shqyrtimi dhe miratimi i propozimit të DÇPJ dhe Kryetarit të Komunës për miratimin paraprak të draft - vendimit për dhënie në shfrytëzim afat gjatë të pronës së paluajtshme Komunale - Zyret të cilat gjinden në Soliter të QPS-së.
9. Shqyrtimi dhe miratimi i propozimit të DÇPJ dhe Kryetarit të Komunës për formimin e komisionit vlerësues për zbatimin e procedurave të dhënies në shfrytëzim afat gjatë të pronës së paluajtshme Komunale - Zyret të cilat gjinden në Soliter të QPS-së.
10. Shqyrtimi dhe miratimi i propozimit të DÇPJ dhe Kryetarit të Komunës për miratimin paraprak të draft - vendimit për dhënie në shfrytëzim afat gjatë të pronës së paluajtshme Komunale - Zyret e katit të III (tretë) të poliklinika stomatologjike, për shërbime gastronomike.
11. Shqyrtimi dhe miratimi i propozimit të DÇPJ dhe Kryetarit të Komunës për formimin e komisionit vlerësues për zbatimin e procedurave të dhënies në shfrytëzim afat gjatë të pronës së paluajtshme Komunale - Zyret e katit të III (tretë) të poliklinika stomatologjike, për shërbime gastronomike.
12. Shqyrtimi dhe miratimi i propozimit të Kryesuesit të Kuvendit për themelimin e Komiteteve të tjera:
 1. Komiteti për Arsim, 2. Komiteti për Shëndetësi, 3. Komiteti për Persona të Moshuar, 4. Komiteti për Urbanizëm.
13. Shqyrtimi i raportit (informatës) mbi zhvillimin ekonomik dhe turizmin në Komunën e Pejës.
14. Shqyrtimi i raportit (informatës) rreth aktiviteteve të KKSB-së.
15. Pyetjet dhe propozimet lidhur me punën e Komunës, të ngritura nga anëtarët, në atë rënditje siç janë pranuar:
16. Çështje të ngritura në mbledhje nga udhëheqësi apo nga anëtarët e Kuvendit.

2.Pjesëmarrja në takim e anëtarëve të kuvendit dhe mungesat.

Në takim mungoj z.Labinot Panxha, znj.Illirjana Gafuri, dhe znj.Gemza Sylejmani Tahirbegolli.

3.Pjesëmarrja publike dhe delegacionet

Nuk ka pasur.

4.Shqyrtimi dhe miratimi i Procesverbalit të Kuvendit të Komunës së Pejës dt. 29.05.2026

Nga të gjithë anëtarët prezent me 20 votë pro, 12 anëtar nuk marrin pjesë në votim, miratohet procesverbali.

5.Rishqyrtimi i Vendimit Nr. 24/2026 për fillimin e procedurës për ndryshimin dhe plotësimin e Hartës Zonale të Komunës së Pejës, 2023-2031, sipas kërkesës së MMPH, me nr. prot. 2356-2/26, dt. 28.05.2026.

Kryesusi Rexhep Kurtbogaj: sipas kërkesës së Ministrisë së Planifikimit Hapësiror dhe Mjedisit është një vendim që është miratuar më 29 prill në këtë kuvend për ndryshim plotësimin e hartës

zonale. Ndërkohë nga ministria ka ardhë për rishqyrtim. Pastaj me ndryshimet që ka kërkuar ministria në këtë dokument ka ardhur përsëri këtu në kuvend. Po e hapi diskutimin për këtë pikë

Z.Drin Veselaj: në seancën e kaluar jemi pajtu që kjo me shku në diskutim publik, mirëpo kisha dasht me ma sqaru për çfarë arsye është kthyer në rishqyrtim edhe a është procedura e njëjtë që ne e votojmë sot, për me shku prapë në diskutim publik! Pak më saktësishtë me dit çka është tu ndodh me vendim edhe arsyeja pse e kanë prurë në rishqyrtim.

Kryetari Gazmend Muhaxheri: ne si asambleë komunale kemi marrë vendim për me çu në bazë të ligjit në procedurë të ligjshmërisë, mbas kthimit të përgjigjes prej ministrisë mandej ne u dasht me i zhvillu procedurat për me i rregullu ato pjesë që i ka mospërputhjen mes planit zhvillimor komunal dhe hartës zonale dhe mandej brenda hartës zonale janë do pjesë tekstuale edhe grafike që s'përputhen. Po teknikisht ministria ditën e fundit në ora 15:40 e ka çu me e-mail që me shqyrtu këtë lajm se s'ju ka dukur që bën me kalu ajo pjesë. Tash ne e kemi çu në drejtori të urbanizmit dhe drejtorja e urbanizmit i ka katër pesë vendime që e njëjta ministri thotë që duhet me u zbatu, po ato nuk munden me u zbatu se ka mospërputhje, mes pjesës grafike dhe tekstuale. Ne çka po kërkojmë qato gabime që janë të bo edhe që kur palë ankohet në ministri edhe ministria i thotë që ke të drejtë me i rregullu, mirëpo ne s'po mundem me i rregullu ato punë sepse zyrtarët atje mandej janë në lajthitje i kanë dy, një e kanë në anën tekstuale thotë ndryshe, pjesa grafike ndryshe. Ne nuk po kërkojmë me ndërru planin zhvillimor komunal, po me i bë përmirësimet në hartën zonale. Përmirësimet janë të lejueshme ligji është i qartë j'a lejon së pari organit kompetent që u marrë me këtë punë edhe në të dytën j'a lejon edhe palës private për me kërku korrigjim ose edhe përmirësim të kushteve për parcellën e vet. Ne po kërkojmë që ato probleme që i ka drejtorja e urbanizmit domethënë me i rregullu rast për rast. Kjo është domethënë ata kanë thënë shqyrtojeni edhe njëherë kërkesën e juaj ne asamble komunale me vendim të drejtorisë për urbanizëm e rishqyrtojmë edhe njëherë sot. Kjo shkon me shumicë votave ndërsa aprovimi i ndryshimeve është me 2/3at e votave. Ndërsa këtë herë me shumicë të votave për me filluar procedurën kur të vjen mbas tre katër muajve me dit sa kohë zgjat kjo procedure ne atëherë sjellim edhe njëherë në seancë edhe me shumicë votave mundohemi me kalu.

Z.Drin Veselaj: kjo arsyeja pse e bëra pyetjen për shkak se ne jemi dakorduar atë ditë që momentin kur fillojnë me u ndryshu qato ka me na ardhë materiali për secilin ndryshim. Edhe këta e pata të paqartë a është rishikim i vendimit për fillim të procedurave apo për ndryshim të kësaj? Domethënë në këtë pjesë jemi në rregull. Kjo është si vendimi i herës së kaluar që e kemi marrë edhe mandej presim me na ardhë dokumentacioni edhe me shqyrtu njëherë.

Kryetari Gazmend Muhaxheri: diskutimi është për ato që ne veç po korrigjojmë, nuk po bëjmë sende të reja një pjesë e madhe atyre shtata rasteve që ministria aprovon palës ankesën po ne jem të detyruar me çu në gjykatë mandej vendimi i gjykatës shkon tre katër vjet domethënë edhe pse ja ka aprovu Ministria, ajo është gati që s'ka përfituar kurrëgjë. Po kjo është se ata zyrtarët atje mandej po frikësohen nuk duanë me marrë përgjegjësi edhe pse ministria ka thënë zbatu ligjin. Po ai ligji është në kundërshtim me vetveten kur ana grafike dhe ana tekstuale nuk përputhen.

Nga të gjithë anëtarët prezent me 26 votë pro, 6 anëtar nuk kanë marrë pjesë në votim, miratohet propozimi i kryetarit dhe drejtorisë për urbanizëmit.

6. Rishqyrtimi i Vendim Nr. 62 -2025 - Planit Ndërkomunal për Menaxhimin e Integruar të Mbeturinave (PNMIM) 2025 – 2035, në bazë të kërkesës së MMPHI për rishqyrtim, me nr. prot: 7271-2/25, dt. 21.10.2025.

Kryesusi Rexhep Kurtbogaj: plani komunal për menaxhimin e mbeturinave ka ardhë nga Ministria për rishqyrtim. Në korrik të vitit 2025 e kemi miratuar. Pastaj në shtator ka ardhë për rishqyrtim. Përsëri e kemi rishqyrtuar. Tani përsëri është si pikë e rendit të ditës për rishqyrtim. Po hapi diskutimin nëse ka dikush nga anëtarë të kuvendit për këtë pikë.

Nga të gjithë anëtarët prezent me 19 votë pro, 11 anëtar nuk marrin pjesë në votim, miratohet plani ndërkomunal për menaxhim të integruar mbeturinave me korrigjimet që janë bë.

7. Shqyrtimi dhe aprovimi i Kornizës Afatmesme Buxhetore 2027-2029.

Znj. Diellza Berisha: në cilësinë e drejtoreshës së financave kam nderin t'ju prezantoj kornizën afatmesme buxhetore për periudhën 2027-2029. Dokumentin më të rëndësishëm strategjik financiar të komunës, i cili përcakton orientimin e planifikimit buxhetor për tre vitet e ardhshme. Korniza e afatmesme buxhetore është hartuar në përputhje me legjislacionin në fuqi për menaxhimin e financave publike dhe udhëzimet e Ministrisë së Financave, Punëve dhe Transfereve. Gjatë hartimit të kësaj kornize janë analizuar projeksionet e të hyrave vetanake, grantet qeveritare, detyrimet ekzistuese financiare si dhe nevojat e drejtorive komunale për financimin e shërbimeve publike dhe investimeve kapitale. Po ashtu në përgatitje të këtij dokumenti kemi mbajtur edhe dëgjim publik me qëllim që planifikimi buxhetor të reflektojë sa më mirë nevojat reale të komunitetit, dhe të forcojë transparencën dhe pjesëmarrjen e qytetarëve në proceset e buxhetimit. Kjo kornizë nuk përfaqëson buxhetin përfundimtar të komunës, po krijon bazën mbi të cilët do të ndërtohet projekt buxheti për vitin 2027 dhe planifikimet për vitin 2028 dhe 2029. Të nderuar anëtarë të kuvendit, tani në pika të shkurta po e bëj një hyrje tek buxheti i komunës së Pejës për vitin 2027. Sipas qarkorës buxhetore të lëshuar nga ministria, komuna e Pejës në vitin 2027 ka një buxhet total prej 44.119.678 euro. Në këtë total granti qeveritar është 37.189.745 euro, kurse të hyrat vetanake komunale pritet të arrijnë 6.929.933 euro në vitin 2027, 7.126.377 euro në vitin 2028, dhe 7.432.935 euro në vitin 2029. Krahësuar me buxhetin e përgjithshëm komunal, pjesëmarrja e të hyrave vlerësohet me 15.71% në vitin 2027, 15.43% në vitin 2028 dhe 15.30% në vitin e 2029. Struktura e të hyrave vetanake dominohet nga të hyrat tatimore, përkatësisht tatimi në pronë dhe tatimi në tokë, të cilat paraqesin burimin kryesor financiar vetanëk të komunës. Sipas projeksioneve këto të hyra për vitin 2027 pritet të arrijnë 3.633.967 euro, vitin 2028 3.666.272 euro, dhe në vitin 2029 3.684.602 euro duke përfaqësuar mbi gjysmën e të hyrave vetanake komunale. Përveç tatimit në pronë, një kontribut të konsiderueshëm në gjenerim të të hyrave japin: drejtoria për planifikim urban dhe mjedis, drejtoria për kadastrë dhe gjeodezi, drejtoria e inspeksionit, drejtoria për shërbime publike, drejtoria për bujqësi, pylltari dhe zhvillim rural, si dhe të gjitha drejtorië të

tjera që ofrojnë shërbime administrative për qytetarët dhe bizneset. Sa i përket kategorisë së shpenzimeve, buxheti komunal për periudhën afatmensme paraqet një trend të qëndrueshëm rritës duke kaluar nga 44.119.678 euro në vitin 2027, në 46.187.733 euro në vitin 2028, dhe 48.594.579 euro në vitin 2029. Struktura e shpenzimeve vazhdon të dominohet nga kategoritë e pagave dhe mediteve, investimet kapitale dhe mallrat shërbimet të cilat së bashku po bëjnë pjesën më të madhe të buxhetit. Sa i përket kategorisë pagat medite në vitin 2027 është planifikuar një total prej 21.481.142 euro. Rritja e kësaj kategorie nuk lidhet me krijimin e vendeve të reja të punës pasi që numri i punëtorëve ka mbetur i njëjtë, por është rezultat i obligimeve ligjore që burrojnë nga ligji për paga në sektorin publik dhe shtesave për përvojën e punës të cilat aplikohen çdo vit. Kategoria e mallrave dhe shpenzimeve këto kategori janë planifikuar duke u bazuar në nevojat reale operative të drejtorive komunale në vitin 2026 kjo kategori ka qenë 5.453.454 euro, ndërsa në vitin 2027 planifikohet të jetë 4.985.490 euro, dhe mbetet pothuajse e pandryshuar edhe në vitin 2028 dhe 2029. Sa i përket shpenzimeve komunale, shpenzimet komunale planifikohen në nivel prej 1.157.240 euro për secilën nga vitet 2027, 2028 dhe 2029 duke mbetur thuajse e pandryshuar gjatë kësaj periudhe afatmensme. Subvencionet dhe transferet paraqesin një instrument të rëndësishëm për mbështetjen e zhvillimit ekonomik, bujqësisë, sportit, kulturës, mirëqenies sociale dhe organizatave të ndryshme. Në vitin 2026 kjo kategori ka qenë 1.362.502 euro. Ndërsa në vitin 2027 kjo kategori rritet ndjeshëm në 1.930.626 euro, kryesisht për shkak të rritjes së mbështetjes në sektorin e bujqësisë. Sa i përket shpenzimeve kapitale, këto shpenzime vazhdojnë të përbëjnë prioritetin kryesor të zhvillimit komunal. Në vitin 2026 kjo kategori është planifikuar 12.707.974. euro. Në vitin 2027 kemi një rritje në 14.565.180 euro. Rritja e vazhdueshme e investimeve kapitale dëshmon orientimin strategjik të komunës drejt realizimit të projekteve infrastrukturore dhe zhvillimore.

Znj. Valbona Taraku Gjakova: duke e shikuar kornizën afatmensme buxhetore 2027-2029 ta jep përshtypjen sikurse është një planifikim i një kryetari i cili është për mandatin e parë qeverisës i cili ka trashëguar shumë probleme dhe punë të pakryme nga paraardhësi i tij, saqë nuk do të dinë si t'ja fillon këto projekte dhe si t'i përfundon. Megjithatë, e vërteta është se kryetari është për mandatin e katërt edhe ka pasur kohë mjaftueshëm tre mandate për me i realizuar këto punë të cilat i ka planifikuar në letër. Korniza e afatmensme buxhetore është dokumenti i cili duhet me përcaktu zhvillimin ekonomik të qytetit apo të komunës së Pejës në tre vitet e ardhshme duke i parë shifrat si të rritjes së buxhetit vërtetë duken mbreslënëse. Po sa po jetësohen këto projekte, sa do ta ndjejnë qytetarët e komunës së Pejës realizimin e këtyre projekteve dhe rritjen e këtij buxheti. Nëse e shikojmë te këtë hyrat vetanake, po e marrim veç shembull inspeksionin. Në vitin 2025 janë të hyra mbi 102.000€ , ndërkaq në vitin 2026 po planifikohen vetëm 43.000€ euro. Nëse inspektimi është përmirësuar atëherë pse po binë të hyrat? Nëse nuk është përmirësuar cili është efekti i punës së këtij sektori? Ndërkaq sa i përket investimeve kapitale, dokumenti përmban dhjetra projekte, rrugë, biblioteka, objekte, impiante e të tjerë. Çka po tregon kjo? Kjo po tregon se Peja dhe mbas tre mandateve të një kryetari ende po përballet me mungesa elementare dhe nevoja bazike. Por problemi nuk është mungesa e projekteve. Projekte paska shumë edhe nuk po dihet cili është më prioritar se tjetri. Problemi është se shumë projekte po shpërndahen disa vite edhe po krijojnë përshtypjen se këto po planifikohen thjesht sa me u prezantu edhe jo me u përfundu. Për shembull infrastrukturë rrugore planifikohen mbi 12.5 milion euro në vitin 2029. Megjithatë shumë lagje në komunën e Pejës shumë fshatra vazhdojnë me pas probleme të njëjta që i kanë pas prej shumë viteve, sidomos qyteti përbrenda infrastruktura rrugore është në gjendje katastrofale. Ka shumë rrugë në komunën e Pejës të cilat

kryetarit as nuk i ka ra në mend me i asfaltu ndonjëherë. E marr shembull rrugën “Avni Rustemi” në lagjen Kapeshnica. Në këtë lagje po na ndërtohen urra të cilat më shumë po krijojnë kaos, mirëpo banorët e Kapeshnicës ende po përballen me mungesë të kanalizimeve funksionale edhe të infrastrukturës rrugore. Nëse kalon me veturë në atë rrugë, secili banor edhe secili kalimtar i vren amortizimin edhe luhatjet e rrugës. Kryetarë, qytetarët nuk jetojnë me premtime të parealizuar të cilat je duke i përsërit prej mandatit në mandat jetojnë me rezultate. Ne si grup i lëvizjes Vetëvendosje nuk jemi kundër zhvillimit. Ne jemi për punë të cilat përfundohen. Edhe e kemi një kërkesë këtë herë Komuna e Pejës e t'i subvencionon nënat lehona ose nënat që lindin për herë të parë. Edhe kjo mundet me u me u realizu prej kategorisë subvencione dhe transfere apo mirëqenies sociale. Nëse don përnime me ndihmu zhvillimin ekonomik, social të komunës së Pejës dhe mirëqenien sociale, hajde ta shohim sa po punojmë në këtë drejtim kryetar.

Kryetari Gazmend Muhaxheri: këtu ju jep një shembull për ekzekutim të projekteve edhe për këto subvencione ju takon juve me jep lehonave se ju e keni marrë bajrakin në dorë për këtë punë edhe jepjuni ju. Po qeveria o për ato punë, edhe për projekte jeni tregu i keni realizuar shumë për këto 6 vjet 20 miliard keni realizuar shumë projekte.

Z.Naim Bytyqi: Edhe te korniza afatmes buxhetore 2027-2029 pothuajse i kemi problemet e njëjta siç i kemi vërejtur vitin e kaluar të korniza 2025-2027. Vitin e kaluar vërejtjet e mia që i bëra në lidhje me projekte të cilat po ju heqen mjetet financiare, kryetari i komunës Gazmend Muhaxheri tha zoti i shtëpisë ja blen biçikletën kujtdo. Unë deri diku mund me u pajtu sepse edhe ligji për vetë qeverisjen lokale thotë që mjetet kryetar i komunës e ka atë kompetencë me i ndërru. Por duhet me ditë ku po bëhen shkeljet në lagjen “Asllan Çeshme” ke shku edhe ju ke premtu këto investime. Pas një kohe ato investime janë larguar dhe janë investuar në një lagje tjetër. Ti aty ke bërë shkelje. E ke marrë votën njëherë dhe pastaj ato mjete janë heq. Ti mundesh me ndërru biçikletën, po tjetërkuj i ke premtu për biçikletë e tjetërkuj j'a ke blerë. Ne përveç se jemi në pozicione ekzekutive dhe legjislative, ne jemi edhe përfaqësues politik, politikisht qytetarët janë në vazhdimësi të mashtruar. Te numri rendor tetë është ujësjellësi për fshatrat e Lugut të Baranit. Duhet me përmend sot për shkak se ata banorë nuk kanë ende ujë. Fajin e kemi sjellë poshtë e përpjet qysh e dini, nuk du me u ndal sot në ato edhe 150.000€ po ndahen. Dhe sot duhet me qenë përgjigjja e saktë a kryhet ky projekt apo nuk kryhet ky projekt? Te numër 13 rregullimi i shëtitores prej urës Novosell te Mullini Bërdynajve, vit pas viti është ka shtyhet. Ka qenë në 2016-ën, u caktu në 2017, tash 2028-ën ka është përparë që të fillojë impianti Kuqisht ka qenë një ndër e premtimet e famshme të kryetarit Muhaxheri në vitin 2021 as në 2026-en s'po parashihet përveç në 2027n 300.000€ euro. Edhe e kam një pyetje specifike të cilën e dua përgjigjen. Jo veç me fol edhe mos me kthi përgjigjen. Ndërtimi për ndriçimin publik, panela solar në Sferk, Lutugllav dhe Gorozhdevc. Këto janë tana në një vend, në një kod, e dua përgjigjen e saktë për këtë. Shtyrja tjetër ka ndërtimi i shtigjeve të hapësirës tjetër ndihmëse për parkun e pishave, premtim i 2021-es, Ndërtimi i sheshit Haxhi Zeka edhe këtu janë heq mjetet. Ndërtimi i sheshit “Shkelzen Haradinaj” janë heq mjetet. Ndërtimi i urës për automjete Bukuresht mahallë, Sallahana edhe këto janë shtyer mjetet për vitin e ardhshëm, mjete të vendosura ku kanë mundësi me u shty prapë ato. Ndërtimi i objektit për persona me aftësi të kufizuar në Vitimëricë që tre vjet është shty tash u heq krejt. Ndërtimi i palestrës në Zahaç edhe 200.000€ janë ndarë 26-ën edhe 200.000€ 27-ën prej vitit 2014 është u ndërtuar kjo qendër sportive. Llogarit njëherë sa milionat janë në të edhe kurrgjë s'është bërë në të hiç. Mjetet për ashensor u larguan, filluat me 150.000€ u larguan, nuk po i shohim më. Qendra e mjekësisë

familjare në fshatin Radavc u ndan mjetet u heqën. Tash s'po përmendet më fusha e sportit në fshatin Qyshkë s'po përmendet më, u heq fusha në fshatin Lozhan është heq. U tha dhe nga parafolësi po vërehet këtu ka me miliona euro të caktuar për rrugë domethënë është mendësia e vjetër me u shtrë ndonjë rrugë, ndonjë dritë eventualisht me mund me bind ndonjë kënd me marrë ndonjë votë prapë. Për mua është dokument shumë i papranuar është dokument që asgjë qytetarëve nuk ju vynë hiç, njerëz janë duke jetu në forma krejt të tjera janë duke avancuar dhe ne hala duke shtuar rrugë tu riparuar rrugë.

Z.Drin Veselaj: Meqë ky dokument është dokument që e parasheh zhvillimin e qytetit për tre vite e ardhshme e që nuk është dokument i cili në fillim të mandatit miratohet edhe mbetet për ato tre vjet, mirëpo jep mundësinë që çdo vit me ndërro. Kjo është edhe ajo esenca që ka mundësi kryetari në vazhdimësi me i zhvendos. Për shembull vitin e kaluar kur e kemi bërë kornizën afatmesme buxhetore për tre vitet e ardhshme e pata potencuar që krejt mjetet i ka zhvendosur në vitin 2026. Mandej këtë vit për 2028, 2029, zakonisht jo për vitin vijues të cilin ne e kemi përpara dhe miratojmë buxhetin, por gjithmonë një vit mbrapa për shkak se vitin tjetër në të njëjtën kornizë mundem prapë me u ndryshu. Këtë e bazoj në faktin për shembull rrugën për Sejnovë Gjëre prej që jam asamblesë këtu në të gjitha kornizat afatmesme buxhetore ka qenë e paraparë mirëpo janë bërë katër mandate që ajo nuk ka përfunduar. Tash në këtë rast janë paraparë me kornizën afatmesme edhe 500 mijë euro. Mirëpo kjo është e pamjaftueshme për me u realizu si projekt. Herën e kaluar para zgjedhjeve e kam potencuar dhe i kam thënë kryetarit kjo është vetëm vazhdimësia e asaj që me u tentu me mendu qytetar që po realizohet edhe nuk ke me realizu. Edhe na patë jep fjalën që para zgjedhjeve kjo kryhet. Mandej, filloi ajo me u punu para zgjedhjeve dhe tash prapë ka stagnuar. Gjithashtu ka edhe shumë projekte të tjera të cilat janë zhvendos paret në vitin 2028, e që vitin 2027 kur kemi me ardhë këtu prapë jemi dëshmitarë të gjithë sepse të gjithë kemi me qenë asamblistë kanë me i vendos në vitin 2029, e kështu 2030 edhe sa të mund me i shty po jo me i realizu projektet. Prandaj unë e marr dhe jo fort serioze këtë farë çështje është formale për shkak se kryetarit i jepet mundësia sa herë që do me ndryshuar kornizën afatmesme për vitin vijues. Kryetari shpeshherë e ka ndërro edhe buxhetin i ka aloku paret në kategori të tjera edhe mbasi ka mundur me bë këtë punë korniza e afatmesme buxhetore thjesht është vetëm një formalitet një document, të cilin e përcjell Ministria e Financave e që është dokument kornizë që mundet me ndryshu sa herë që i vyn për qëllim elektorale.

Kryetari Gazmend Muhaxheri: Naimi, kërkoi përgjigje specifike për solaret. Komuna e Pejës, Naim, ka nda 1 milion e 300 mijë euro një për tre hektar solare. Jemi komuna e vetme në Republikën e Kosovës e cila rrym prej vitit nëse e kryejmë investimin prej vitit 27 po edhe po e shtyjme 28-ën kemi me qenë diku barabart ose zero me zero. Kjo punë bëhet ose më është dashur me bërë për shkak se i kemi 280 punëtorë në ndërmarrjen publike të cilët duhet me ju siguru rrogat dhe me ligjin e ri duhet me ju siguru dhe rrogat e rritura. Për këtë arsye kushdo që vjen mbrapa në komunën e Pejës energjinë elektrike për ndriçim publik për shkolla dhe për ambulanta të paguara. Tash veç me Drinin duhet mu e marr vesh a me investu në rrugë a jo? Naimi po thotë mos investo në rrugë, Drin ti po thua investo në rrugë, diskutoni ndër me vete ta di! Për parkun e pishave e ka një problem edhe në hartën zonale tham që duhet me rregullu sepse parku i pishave i përfshin dy parqe, njëri është majë të zezë, tjetri në Brestovik, ndërsa ai operatori i Gizit si zonë për sport dhe rekreacion janë përfundër parkut që ka enë i obliguar vetëm këto dy parë me pisha me i përfsh i ka përfshir dhe pronat private dhe tash problem ata pronarët e

pronave private s'munden me marrë leje dhe me zhvillu hapësirat e tyre private. Nuk kemi mund me buxhet se 15 milion euro i kemi paguar edhe jemi e vetmja komunë që i ka pagu një vjet para zgjedhje dhe në vitin zgjedhor. Krejt komuna të tjera i kanë shty këtë vit domethënë obligimet ligjore që i kanë të kontratës kolektive me i pagu. Krejt investimet që bëhen janë në funksion të fitimit të zgjedhjeve të 29-ës. Edhe normal që qytetarët kanë me qenë të kënaqur me këto investime shumë edhe po besoj që kanë me qenë të qëllume. Në Lozhan nuk është salla e sportit, është shkolla e kemi fut këtë herë me ndërtu, ndërsa sallën e sportit e parashohim me e mbaru me një buxhet tjetër ndonjëherë tjetër. Ujësjiellësi i Lugut Baranit i kemi aplikuar për krejt lejet. Ne jemi të shohim çka po na thot qeveria, paret i kemi nda nëse duhet edhe me me shtu, kemi me i shtu në këtë buxhet. Po s'kemi hequ dorë kurrë për me kryer atë buxhet. Mundem me kërku me i shtu edhe 1.000 metra gyp për me sjellë edhe një burim të dytë, tek ky burim i ujit që e kemi dhe po besoj që ka me qenë e mjaftueshme për me i furnizuar me ujë jo vetëm këto fshatrat e Lugut të Baranit po me i ndihmu edhe rrjetit të ujësjiellësit dhe për këto fshatra të tjera ose për qytet.

Nga të gjithë anëtarët prezent me 20 votë pro, 12 anëtar nuk marin pjesë në votim, miratohet Korniza Afatmesme Buxhetore 2027-2029.

8.Shqyrtimi dhe miratimi i propozimit të DÇPJ dhe Kryetarit të Komunës për miratimin paraprak të draft - vendimit për dhënie në shfrytëzim afat shkurtër të pronës së paluajtshme Komunale - dy sportele për aktivitete bankare.

Kryesusi Rexhep Kurtbogaj: Po e hapim diskutimin për anëtarët e kuvendit nëse kanë për diskutim. Drejtorin e kemi prezent nëse kërkohet ndonjë sqarim shtesë rreth kësaj pike.

Nga të gjithë anëtarët prezent me 20 votë pro, 12 anëtar nuk marin pjesë në votim miratohet propozimi i DÇPJ dhe Kryetarit të Komunës për miratimin paraprak të draft - vendimit për dhënie në shfrytëzim afat shkurtër të pronës së paluajtshme Komunale - dy sportele për aktivitete bankare.

9.Shqyrtimi dhe miratimi i propozimit të DÇPJ dhe Kryetarit të Komunës për formimin e komisionit vlerësues për zbatimin e procedurave të dhënies në shfrytëzim afat shkurtër të pronës së paluajtshme Komunale - dy sportele për aktivitete bankare.

Kryesusi Rexhep Kurtbogaj: Tash është fjala për komisionin që duhet t'i përcjellë procedurat për dhënien në shfrytëzim të këtyre dy sporteleve. Komisioni përbëhet nga pesë anëtarë. Është komision që është ekskluzivisht krijohet për këtë procedurë. Nuk ka mandat tjetër.

Anëtarët e kuvendit të propozuar;

Gentiana Bajrami Atashi- LDK

Fatime Shala- PDK

Z.Drin Veselaj: edhe pse ne nuk jemi pjesë e këtij komisioni. Njëherë kemi qenë gjatë krejt kësaj pjese edhe qatë ju kena pengu. Tash s'jemi më. Po në rregull është. Po kish qenë mirë me qenë të kujdesshëm me shoqërinë civile për shkak se në dy komisione i keni fut njerëz që janë aktiv në këshilla lokal, edhe kjo është edhe me ligj nëse nuk gaboj është e ndaluar. Duhet me qenë shoqërisë civile, e jo njerëz të këshillave lokale.

Kryesusi Rexhep Kurtbogaj: me sa e di unë nuk nuk është e kundërligjshme që të jetë një anëtar i bashkësisë lokale si pjesë e komisionit. Megjithatë edhe pse nuk e kam analizuar më thellë besoj që është e sigurtë që nuk ka ndonjë kundërshtim.

Nga të gjithë anëtarët prezent me 19 votë pro, 11 anëtar nuk marin pjesë në votim miratohet i propozimi i DÇPJ dhe Kryetarit të Komunës për formimin e komisionit vlerësues për zbatimin e procedurave të dhënies në shfrytëzim afat shkurtër të pronës së paluajtshme Komunale - dy sportele për aktivitete bankare.

10.Shqyrtimi dhe miratimi i propozimit të DÇPJ dhe Kryetarit të Komunës për miratimin paraprak të draft - vendimit për dhënie në shfrytëzim afat gjatë të pronës së paluajtshme Komunale - Zyret të cilat gjinden në Soliter të QPS-së.

Kryesusi Rexhep Kurtbogaj: nëse ka dikush për diskutim, apo sqarime shtesë nga ekzekutivi përpos materialit që është dërguar te anëtarë të kuvendit? Nuk ka atëherë e qesim në votim për aprovim.

Nga të gjithë anëtarët prezent me 19 votë pro, 11 anëtar nuk marin pjesë në votim miratohet propozimi i DÇPJ dhe Kryetarit të Komunës për miratimin paraprak të draft - vendimit për dhënie në shfrytëzim afat gjatë të pronës së paluajtshme Komunale - Zyret të cilat gjinden në Soliter të QPS-së.

11.Shqyrtimi dhe miratimi i propozimit të DÇPJ dhe Kryetarit të Komunës për formimin e komisionit vlerësues për zbatimin e procedurave të dhënies në shfrytëzim afat gjatë të pronës së paluajtshme Komunale - Zyret të cilat gjinden në Soliter të QPS-së.

Kryesusi Rexhep Kurtbogaj: fjala është për komisionin e që formohet për zhvillimin e procedurave. Dy anëtarë të Kuvendit, dy anëtarë nga ekzekutivi dhe një nga shoqëria civile.

Anëtarët e kuvendit të propozuar:

Dafina Draga-LDK

Nasret Hajrizi- PDK

Nga të gjithë anëtarët prezent me 20 votë pro, 12 anëtar nuk marrin pjesë në votim miratohet, propozimi I DÇPJ dhe Kryetarit të Komunës për formimin e komisionit vlerësues për zbatimin e procedurave.

12.Shqyrtimi dhe miratimi i propozimit të DÇPJ dhe Kryetarit të Komunës për miratimin paraprak të draft - vendimit për dhënie në shfrytëzim afat gjatë të pronës së paluajtshme Komunale - Zyret e katit të III (tretë) të poliklinika stomatologjike, për shërbime gastronomike.

Z.Drin Veselaj: Mu duk shumë e çuditshme ose ndoshta edhe nuk po më kujtohet këtë fjalë për shërbime gastronomike, me sa e di edhe kam lexuar kjo gastronomike është shërbime restorante, kafene, bare, fastfood dhe nuk po më kujtohet çka ka të bëjë kjo me shërbimet e poliklinikës, për shërbime stomatologjike. Mos keni gabim, mos keni dasht gastroskopi që ka të bëjë me shëndetësi? Edhe nuk po më kujtohet se këta kush është doktor këtu e din që pasi pas intervenimit në dhëmbë, zakonisht rekomandohet dy deri në tre orë mos me përdor ushqim as pije të nxehtë as të ftohta. Nuk po kujtoj për çka po doni me jep 35 vjet këto me ma shpjegoni për mua është jashtëzakonisht e pakuptueshme pse duhet me pas aty shërbime gastronomike. Nëse e keni hallin e pacientëve aty ka shërbime gastronomike poshtë e nëlta sa të keni qejf, nuk po nuk po di pse duhet 35 vjet me jep dikujt këtë në shfrytëzim, sepse ne e dimë që jeni mburë e krekos me këtë farë poliklinike edhe tash prej poliklinikës stomatologjike po doni me kalu në poliklinikë gastronomike.

Kryetari Gazmend Muhaxheri: objekti kur është ndërtuar është mbaruar kati i fundit me qenë në restorant. Unë si kryetar komune kam thënë që nuk e investoj se s'kam qysh e mbajmë ne si restorant në atë pjesën. Domethënë objekti është ndërtuar me Ministrinë e shëndetësisë edhe pjesa e parë është objekt multifunksional për trajnime për regjionin e Dukagjinit. Pjesa e parë e kemi vendosur në emergjencën edhe disa shërbime të tjera të ÇKMF-së. Kati i dytë është i ndamë për salla që kanë me shërbyer për trajnime të ndryshme në komunën e Pejës. Kati i fundit e ka hymjen prej spitalit edhe është i projektuar për me qenë restorant. Tash mundem me lënë mos me jep kurrkujt hijë e me shku dëm ashtu si objekt ose mundem me jep farë privati që konkuron e merr, edhe jep shërbim edhe për sa i kemi aty 45 të punësuar në poliklinikë edhe për ata që i keni të punësuar në spital edhe mundet me shërbyer edhe më shumë kaq është kjo punë.

Nga të gjithë anëtarët prezent me 19 votë pro, 11 anëtar nuk marrin pjesë në votim miratohet, propozimi i DÇPJ dhe Kryetarit të Komunës për miratimin paraprak të draft - vendimit për dhënie në shfrytëzim afat gjatë të pronës së paluajtshme Komunale - Zyret e katit të III (tretë) të poliklinika stomatologjike, për shërbime gastronomike.

13. Shqyrtimi dhe miratimi i propozimit të DÇPJ dhe Kryetarit të Komunës për formimin e komisionit vlerësues për zbatimin e procedurave të dhënies në shfrytëzim afat gjatë të pronës së paluajtshme Komunale - Zyret e katit të III (tretë) të poliklinika stomatologjike, për shërbime gastronomike.

Kryesusi Rexhep Kurtbogaj: fjala për poliklinikën stomatologjike komision për dhënien e shfrytëzim zyrë të katit të tretë komisioni, dy anëtarë të kuvendit, dy nga ekzekutivi dhe një nga shoqëria civile.

Anëtarët e kuvendit të propozuar;

Arben Morina-LDK
Edonjeta Berisha- PDK

Nga të gjithë anëtarët prezent me 19 votë pro, 11 anëtar nuk marin pjesë në votim miratohet, i propozimi i DÇPJ dhe Kryetarit të Komunës për formimin e komisionit vlerësues për zbatimin e procedurave.

14. Shqyrtimi dhe miratimi i propozimit të Kryesuesit të Kuvendit për themelimin e Komiteteve të tjera: 1. Komiteti për Arsim, 2. Komiteti për Shëndetësi, 3. Komiteti për Persona të Moshuar, 4. Komiteti për Urbanizëm.

Kryesusi Rexhep Kurtbogaj: fjala është për shqyrtimi dhe miratimi i propozimit të kryesuesit të Kuvendit për themelimin e komiteteve të tjera. Komiteti për arsim, Komiteti për shëndetësi, Komiteti për persona të moshuar dhe komiteti për urbanizëm. Këto janë tre komitete se kanë qenë edhe mandate të tjera që është informuar nga Kuvendi si trup ndihmëse për kuvend dhe ekzekutiv. Ndërsa komiteti për personat moshës së tretë është komitet që është propozuar, komitet i ri në këtë mandat. Po e hapi diskutimin nga për anëtarët e Kuvendit. komitetet përbëhen nga pesë anëtarë, tre anëtarë të kuvendit dhe dy anëtarë jashtë kuvendit. I marrim emrat e anëtarëve të kuvendit sipas subjekteve politike që i propozojnë. Fillimisht po kërkoj për komitetin për arsim ashtu qysh e keni edhe në material nga subjekti i parë propozimin.

Komiteti për Arsim- anëtarët e kuvendit të propozuar:

1. Gentiana Bajrami Atashi- LDK
2. Vlera Kuqi- AAK
3. Hidajete Nikçi- LVV

Komiteti për shëndetësi- anëtarët e kuvendit të propozuar:

1. Drita Lokaj Maloku
2. Ilirjana Gafuri
3. Gemza Sylejmani Tahirbegolli

Komiteti për Përsone me Aftësi të Kufizuara- anëtarët e kuvendit të propozuar:

1. Islam Husaj-LDK
2. Shaban Ramaj-AAK
3. Leotrim Murtezaj

Z.Berat Ganiqi: Domethënë çdo rregull DSP-ja me të gjitha i ke ndjekur subjektet qysh janë radhitje. Edhe pse e ke tejkaluar AAK-në, ja ke jap PDK-së. Tash po mundohesh me kalu Vetëvendosjen me jep PDK-së propozimin. Nuk lejohet. Përndryshe procedojmë me ankesë edhe ndaj kësaj mbledhje sepse më së pari nuk janë të krijuar kushtet me mbajt këtë mbledhje. Krejt mbledhjen tu e mbajt. Hajde po heshtim një herë, dy herë, prej vitit 2021 që jemi këtu. Ja keni problem me mikrofon, ja keni problem me inçizim, ja keni problem me diçka në këtë mbledhje. Nuk mbëhet seanca kështu, kryetari çdo ditë thotë kam kam unë pare, kam pare, kam pare, një mikrofon nuk e rregullon. Foli deri pak pare për zhvillim ekonomik. Një sallë ku bëhet mbledhja nuk në rregull. Andaj të lutem propozimi na takon neve, procedojmë kështu ndryshe. Nuk vazhdojmë as mbledhjen përkundrazi ankesë sepse nuk i takon.

Kryesusi Rexhep Kurtbogaj: nuk është qëllimi me pasë tendence me ju përjashtu, po nuk ka as kriter që me thënë duhet me qenë gjithqysh Lëvizja Vetëvendosje e treta në bazë numrit të votave për shkak se një dispozitë që ka të bëjë me komitete thotë duhet me të gjitha subjektet përfaqësuar. Nuk është qëllimi me ju përjashtu me pas ndaj subjektit tuaj, por rregullorja e thotë përfaqësim të gjithë subjekteve politike.

Komiteti për Urbanizem- anëtarët e propozuar:

1. Nasret Hajrizaj-PDK
2. Mirsad Berisha- PLE
3. Muamel Dupljak-BSK

Z.Drin Veselaj: të dy partitë janë edhe në komunitet për komunitete edhe nuk e di a lejohet kjo farë pune. A e di se është edhe Mirsadi konsulltohu edhe njëherë se më duket që nuk lejohet. Kështu që qysh ta vlerësoni po më duket që nuk bën. Meqë janë komitete konsultative edhe që kanë me ju jep sugjerime për shembull drejtorivë respektive është mirë me qenë pak me mendime pak më të ndryshme, për shembull të opozitës edhe ju kishim ndihmu edhe këtyre tash për shembull Artës mundet prej PDK-së, edhe kështu jashtë komunitetit me sugjeru për ndonjë punë të mirë.

Kryesusi Rexhep Kurtbogaj: nuk ka të përcaktuar që e ndalon me qenë në komitete të tjera. Po ne gjithsesi sugjerimin e juaj dhe ato çka e keni që ju preokupon e bëjmë pyetjen në ministrinë nëse është në kundërshtim atëherë duhet me gjet një model për me i ndërru.

Nga të gjithë anëtarët prezent me 18 votë pro, 1 votë e përmbajtur, 11 anëtar nuk marrin pjesë në votim miratohet, propozimi i Kryesuesit të Kuvendit për themelimin e Komiteteve të tjera: 1. Komiteti për Arsim, 2. Komiteti për Shëndetësi, 3. Komiteti për Persona të Moshuar, 4. Komiteti për Urbanizëm.

Z.Naim Bytyqi: më së pari është te rendi i ditës te pika 14. Më së pari s'ke material për të. E para i ka shkruar komisionet për arsim, për shëndetësi, për persona të moshuar edhe për urbanizëm. Ku është materiali si e thotë se Aleanca nuk bën me qenë, Vetëvendosja s'bën me qenë që ose LDK-ja bën me qenë a je tu kuptu? Ne paraprakisht mbajmë takim edhe mundohem me i nda qëto detyra në proporcion. As materialin nuk e ke e si është shkelje ajo është 100% e ka sigurtë që ai s'i punon një komision e në tjetrin me pagesë në tjetrin nuk ka asnjë mundësi ligjore. Po unë të kisha thënë me shty e të shqyrtojmë. Më së pari u desht me pas vendimin ti sot, zgjidhni njëherë problemin mos të kem telashe më. I ke ngarkuar, anëtarët, me 10 pozicione dikë e ke lënë jashtë krejt. E thotë ligji ama ligjin cili e thotë ama të lexoj unë.

Z.Avni Gashi: përsa i përket themelimit të komiteteve të tjera në udhëzimi administrativ MAPL 05/2020 për procedurën e themelimit përbërjen dhe kompetencat dhe komitete të përhershme dhe komitete të tjera në komuna thotë që secili kuvendi duhet t'i themelojë këto komiteti dhe përbërja e këtyre komiteteve duhet të përfaqësohet nga të gjithë anëtarët e kuvendit. vendit. Ne i kemi themeluar katër komitete. Tasht ti s'mundesh me i nda në proporcion krejt. LDK-ja përfaqësohet prej 14 anëtarëve të Kuvendit dhe i kanë takuar tre komitete. Tash ju përfaqësoni prej tetë anëtarëve të Kuvendit i keni tre komitete s'mundeni me nda ndryshe. Në këtë rast anëtarët që e kanë më pak PDK-ja i ka dy komitete, por në këtë si subjekt i tretë edhe Lëvizja Vetëvendosje gjithashtu dhe komitetet duhet me u përfaqësu, në këtë kuvend komiteti jo shumicë që janë nga një komunitet. Udhëzimi administrativ tash me nen mundem me kqyr thotë që duhet të gjithë anëtarët, të gjitha subjektet duhet me qenë të përfaqësuar. Në këto komitete thirren komitete të tjera. S'janë komitete konsultative. Po thirren ashtu komitete të tjera. Edhe një anëtar sa i përket asaj çështjeje, një anëtar i komitetit tjetër në këtë rast Islam Husaj si anëtar i komitetit për persona të moshuar, nuk mundet me qenë pjesë anëtar një komiteti tjetër në këtë rast të urbanizmit, të arsimit ose shëndetësisë. Ndërsa në komitete të tjera mundet me qenë fjala jo për këto që u themeluan sot, po komitete për shembull komisione të tjera.

Z.Drin Veselaj: udhëzimi administrativ numër 05/2020 për procedurën e themelimit dhe përbërjen e kompetencat e komitet të përhershme dhe komitete të tjera. Përbërja dhe organizimi i komiteteve të tjera. neni 14. pika tre, anëtarët e komiteteve të tjera nuk kanë të drejtë të jenë më shumë se sa një komitet. Ndoshta kanë shkruar këta gabim. Unë po lexoj çka po shoh!

Z.Avni Gashi: për shembull Islam Husaj ka të drejtë me qenë vetëm komitetit për persona me moshë të tretë. Nuk ka të drejtë me qenë komitetin për shëndetësi që u themelua sot. Nuk ka të drejtë me kërk. Komitete të tjera lexohet anëtarët e komiteteve të tjera nuk kanë të drejtë të jenë më shumë se një komitet.

Z.Islam Husaj: Drini këtu ka të drejtë edhe anëtarët e komiteteve të përhershme nuk mund të jenë në komitete të tjera. Në asnjë komitet as anëtarët e komiteteve të tjera nuk mundën me qenë në komitete të tjera. Kështu shkruan në udhëzim administrativ është neni i pestë pika katërt. Thotë anëtarët e komiteteve të përhershme nuk kanë të drejtë të jenë edhe anëtarë të komiteteve të tjera.

Z.Drin Veselaj: neni pesët është kjo tjetër a po kupton unë nuk jam jurist me profesion po e kam aftësi me dit, se neni me nenin mundet me dallu unë ta lexova nenin e 14 duke shpresuar që Islami kyqet në këto dhe e din doktori.

15.Shqyrtimi i raportit (informatës) mbi zhvillimin ekonomik dhe turizmin në Komunën e Pejës.

Kryesusi Rexhep Kurtbogaj: e keni marrë një material paraprakisht nga drejtorja, një material që kemi diskutuar dhe në takimin e KPF-së. Një raport informativ nëse ka dikush për diskutim drejtorin e keni prezent.

Znj.Valbona Taraku Gjakova: para se me hy në analizë të raportit të zhvillimit ekonomik dhe turizmit të Pejës, mbasti po vërehet që shumë ka drejtime gabime drejtshkimore saqë është vështirë edhe me lexu edhe me kuptuar këtë raport edhe kjo u mundua me u mbuluar me do fotografi të bukura të cilat janë nxjerrë nga ASK-ja. Mirëpo kërkoj për me pas pak më shumë kujdes në këto raporte se po duket jo serioze kur po na dërgohen materiale të cilat kanë gabime që ndoshta i bëjnë edhe fëmijët nxënësit e klasës së parë. Kur hymë tek analiza e raportit, ky raport e ka një problem themelor, na paraqet aktivitete, po nuk na jep rezultate konkrete. Thuhet se janë mbajtur takime me 15 biznese, janë vizituar mbi 10 OJQ, Po çfarë ka përfitu komuna e Pejës nga kjo punë? Cilat projekte kanë dalë nga këto takime? Çfarë bashkëpunime konkrete janë krijuar? Sa kanë përfituar bizneset lokale? Edhe sa është rritur oferta turistike e Pejës? Gjithashtu thuhet se mbi 4120 vizitorë kanë kërkuar informacion, por ne nuk keni informatë sa prej këtyre kanë qenë turistë të huaj, çfarë kanë kërkuar, sa janë orientuar drejt ofertës lokale edhe çfarë ndikimi konkret ka pasur kjo në promovimin e komunës së Pejës edhe në ekonominë lokale. Por në anën tjetër problemi kryesor po na e paraqet vetë drejtorja po thotë se ka mungesë stafit edhe se puna po bllokohet nga kjo mungesë. Kjo tregon që ose pushteti lokal nuk po e trajton seriozisht zhvillimin ekonomik, meqënëse shihet kjo ashiqare ose është lejuar drejtorja me punu me kapacitete minimale në mënyrë që me justifikuar mungesën e rezultateve. Le ta kemi të qartë që zhvillimi ekonomik të nderuar kolegë nuk matet me sa OJQ janë vizituar, sa takime janë mbajtur, po sa është forcuar ekonomia lokale, sa kanë përfituar bizneset lokale edhe çka kanë ndryshu në jetën e qytetarëve të komunës së Pejës. Kërkoj një raport përtej formalitetit, një raport serioz me indikator të matshëm edhe që tregon një rezultat konkret.

Kryesusi Rexhep Kurtbogaj: edhe në takimin e KPF-së e kam përmend njëri prej faktorëve që ka një stagnim të turistave në qytetin e Pejës është moskujdesi dhe mosinvestimet e qeverisë. Jo që ka ndikuar shumë po tepër duke u marrë parasysh si Peja si qytet turistik shumë i frekuentuar nga turistë të vendit edhe jashtë vendit për vite me radhë ka pasur një rritje të ardhna, dhe një rritje ekonomike si shkak i fluksit të turizmit dhe asetetit që i kemi, bjeshkën edhe vendet kulturore dhe atraktive që i kemi në komunën tone. Duke marrë parasysh edhe rrugën e Rugovës, domethënë territorin e Rugovës që është pjesa kryesore që frekuentohet nga turistët e jashtit.

Gjithsesi në secilën anë në Radavc apo në qytet në Rugovë, turistat që vijnë të ardh na përfitojmë të gjithë çka jemi si qytet si zonë rurale, komplet domethënë ndikon në rritjen e standartit të jetës. Për këto vite të fundit është si faktor kryesor që kanë ndikuar ekstrem shumë për ramjen e numrit të turizmit njëkohësisht që ka ndikuar edhe në ekonominë e qytetit.

Znj.Valbona Gjakova Taraku: është e vërtetë që infrastruktura rrugore ndikon edhe negativisht. Ne nuk po e mendojmë përgjegjësinë e ministrisë edhe në rregullimin e rrugës. Rruga ka me u ndërtu dhe ka me u bë. Po ne jemi duke diskutuar sot raportin e Drejtorisë të Zhvillimit Ekonomik, jo raportin e Ministrisë. edhe ta shohim çka ka bërë komuna e Pejës ky drejtorat për me zbut këtë problem edhe çka ka kompetenca të veta. Jemi duke diskutu për nivel lokal, për kompetenca Drejtorisë së Zhvillimit ekonomik. Nuk po flasim për nivel nacional edhe për Ministrinë e Caktuar.

Kryesusi Rexhep Kurtbogaj: po ky është raporti i drejtorisë për zhvillimin ekonomik dhe zhvillim të turizmit. Edhe unë e kam të drejtë me e përmend edhe pse s'mundesh me ik që është një faktor kryesor që qeveria ka ndiku në faktor kryesor. A di nuk mundesh me ik kësaj teme se shkak kryesor është ajo. Tash ky drejtori e ka dhënë raportin e vet. Po unë e përmend mbështjen zhvillimi i turizmit edhe kjo edhe e përmenda si anëtar i kuvendit një fakt që është relevant.

Z.Shaban Ramaj: ne po folim për turizëm po kushte s'po ka aty. Hajde në Radavc s'ke kushte, s'ke shporta të bërlllogut.Unë pata me fol edhe shumë të tjera. Po me iku Araniti, kryetari me Fatmirin më duket si me fol si mos me fol të njëjtë. Drejtor hajde vizito se s'ke shportat bërlllogut. Po na shen gjithkush aty është tmerr. Hajde vizito janë njerëz që shesin aty të duanë kushte. Hajde se s'u kushton kurrëgjë unë të çoj me kerr edhe kqyri qysh duhet edhe as s'kam nevojë me filozofu. Andej është mirë me marrë masa bile kontratat e bërlllogut. Unë e kam bë i kam thënë një ditë të drejtorit të mirëmbajtjes bjeri dy tre punëtorë në sezon se sa njeri po vjen, po më vjen marre prej njerëzve aty. Edhe kërkesa shumë e madhe dhe prej atyre njerëzve, prej komunitetit aty edhe të kisha lut me marrë masa sa më shpejt domethënë edhe tash jemi në gjysë sezone kurrëgjë s'keni marrë masa edhe wc publike s'e keni lëshua hala, a kur lëshohet dimrit kur s' vjen kurkush!

Z.Drin Veselaj: sa i përket turizmit edhe zhvillimit ekonomik, unë ju kam potencuar në vazhdimësi që na falë Zoti që na i ka krijuar këto bukuri e këto mundësi edhe zhvillohet turizmi. Sa i përket komunës së Pejës që ka bërë diçka për turizmin është zero. Nuk paragjykoj drejtori tash ka ardhë, mirëpo edhe në të kaluarën kur ka qenë drejtori tjetër, unë e kam potencuar një vend i cili dëshiron me zhvilluar turizmin e me pas zhvillim ekonomik, buxhetin kryesor duhet me nda për atë pjesë. Ndërsa Drejtoria për zhvillim ekonomik edhe turizëm e ka një buxhet, nëse s'gabo, 200.000€ që fletushka nuk mundet me bë me ato pare. Pra sa i përket kësaj komune me fjalë është turizmi, me vepra nuk është turizmi. Drejtoria për çështje pronësore juridike është më e vlefshme, më e rëndësishme për komunën e Pejës se sa Drejtoria për zhvillim Ekonomik. Kjo tregon edhe në bazë të pikave të rendit të ditës, çdo seancë i kemi nga 10 pika të Drejtorisë për çështje pronësore juridike e nganjëherë në dy vjet e kemi një pikë për zhvillim ekonomik edhe turizëm. Prandaj prioriteti i kësaj komune nuk është zhvillimi i turizmit është duke u keqpërdorë

në kuptimin që turistat janë ka vijnë me i pa këto bukuri. Mirëpo çka ne po ju ofrojmë atyre turistave? E potencoj Shabani nuk ka shporta të mbeturinave të cilat janë elementare për një vend. Nëse vini në Radavc e shihni për shembull çfarë mirëmbajtje, çfarë gjendje është ajo pjesë e cila ofron mundësi që me ardhë turistat prej gjithë rajonit e botës e vijnë e kënaqen këtu. Fatmirësisht aty janë disa disa restorante të cilët në mënyrë vullnetare mundohen nga pak me pastru. Mirëpo ne jemi tuke fol këtu për ë impaktin e komunës në turizëm. Komuna e Pejës zero ka bërë për turizmin, sepse drejtorisë për zhvillim ekonomik edhe turizëm nuk ja ka lejuar duart bile nuk dashur me jep edhe partnerit të koalicionit. Ndoshta këtë drejtori kur e ka ditur që nuk ju beson fort koalicionit edhe zakonisht jep drejtori që si ka fort të rëndësishme për vete. Kryetari edhe LDK-ja është dasht me marrë këtë drejtori edhe me zhvillu turizmin. Unë qështu e shoh komuna e Pejës ka bërë zero për me i kriju kushtet për turista ndërsa Zoti na i ka falë këto bukuri e shyqyr që nuk ka kush prej njerëzve në tokë që ka fuqi me i shkatërru.

Z.Naim Bytyqi: kryesues nuk deshta me marr fjalën hiç por meqënëse jam edhe anëtar i komitetit për politikë dhe financa fillimisht ky material po vjen aty po e trajtojmë. Tema është sot këtu me u diskutu një raport, jo me u diskutu tema e përgjithshme për turizmin. E treta herë që jemi ka dalim prej rendit të ditës është ardh një raport ne kemi diskutu qatë raport, a është ai raport në rregull, a i ka plotësuar kushtet raporti, a ka mangësi raporti, apo në çfarë gjendje është ai raport. Është e vërtetë ajo dhe çka the ti problemi i rrugës kryesore është sidomos te zona e Rugovë. Meqenëse Peja e ka si pikën kryesore referente për turizëm Rugovën, rruga kryesore e dëmton turizmin po s'është e përfshirë në raport s'është e përmend rruga a po kupton s'di sa po mundesh me kuptu ne kemi cek këtë raport me tre faqe. Ne kemi me fol për atë, por tema është jashtë saj. Ne mundem me të përgjithshmet mundem me fol me marrë dikush fjalën dhe me fol për turizmin. Andaj unë po kërkoj për shembull teleferikun në sezonin e dimrit nuk punon hiç edhe pse është teleferiki privat nuk ka lajmërim poshtë që s'ka teleferik. Vjen dikush prej Prishtinës i bën 22 km deri në Bogë kur shkon aty e sheh si teleferiku nuk punon. Puna e drejtorisë është me qit një informatë. ju mundeni me shku po për teleferik mos shko se nuk është aktiv nuk punon, që kjo është e drejtorisë dhe ajo duhet me u përfshi në raport. Është e vërtetë çka tha dhe parafolësi që janë përfshir me informatat prej ASK-së, në rregull është pse janë përfshir edhe ato po duhet edhe informata tuja ti çka ke punu gjatë këtij viti, duhen me përfshin në raport shumë e thjeshtë. Sa dush na thush neve për rruga kryesore raportin e përfshirë rruga kryesore s'është, e shumë arsye të tjera si kanë. Unë e kam quajt me plot të drejtë edhe një medium ka vdekur turizmi në Rugovë është i vdekur. Ne për shkaqet mundem me fol, ulem folim tër ditën. Ama unë po bëj lutje dhe po bëj thirrje edhe njëherë të flasim për raporte se ne jemi zyrtarë.

Z.Nasret Hajrizi: atëherë të nderuar po flasim për raportin e turizmit, zhvillimit ekonomik. Ne duhet me e dit se shumë fjalë fliten, por realisht çdo punë janë bërë dhe janë duke u bërë boll. Ju e dini që paraprakisht ka pasur vizitë rreth 600.000 fjetje janë në komunën e Pejës nga turizmi. Nuk flasim me fjalë në qiell, po me shifra zyrtare që i marrin nga ASK-ja, Drejtoria e Zhvillimit

Ekonomik. Ndërsa sa i përket asaj se çka u bë për vitet paraprake, ne lirisht mund me thënë se komuna e Pejës ka bërë shumë më shumë apo 100% më shumë se krejt qeveria e Kosovës për zhvillimin e turizmit në komunën e Pejës. Absolutisht qeveria e Kosovës asnjë cent s'e ka dhënë për Drejtorinë e Zhvillimit Ekonomik që qëllimi i tyre është me zhvillu turizmin. Kështu që ish mirë me u sjellë rreth raportit, mos me kqyr presje pika, por me kqyr se çfarë po bëjnë ata me 20 miliard euro apo çfarë kanë bërë me 20 miliard euro për zhvillimin e turizmit në kuadër të komunës së Pejës edhe të Kosovës. Apo nëse mund me na thënë ndonjë informat se cila është arsyeja që është ndalë ndërtimi e inkubatorit të biznesit për komunën e Pejës, mosbesimin në ministren paraprake apo çka është në pyetje? Këto janë shumë elemente që ish dashur me i pa ata kritikuesit, sidomos ata që e kanë pushtetin sot të përgjithshëm edhe financiarin edhe buxhetin e shtetit me e pas me thënë ata se ne e bëmë këtë po ju çka bët realisht ne Peja. Shumë e vërtetë se turizmi në Rugovë ka lëndime ka probleme po problemi kryesor është rruga që është kompetence pushtetit qendrorë nuk është kompetence lokale për këtë arsye kur të flasim për raport duhet të të rrethohem rreth raportit, e jo se cili është problemi apo kush po i bën problemet. Saktësisht e dimë se veç një punë e ka bërë qeveria për këto katër vitet zhvillimin e strategjisë së zhvillimit të turizmit. Asgjë tjetër. Asnjë investim se ka pru në komunën e Pejës. S'po flas veç për komunë Pejë, por po flasim edhe për komuna të tjera ku kam qenë unë paraprakisht. Kështu që mirë shkon që ju që e keni pushtetin absolut atë me ju thënë ngadalë hajde kthehuni në Pejë. Jo veç për reklamë me dy kamiona zallë në rrugë të Rugovës me i marrë votat, po me pas projekte konkrete edhe me e nxit edhe më shumë ardhjen e turistave në komunën e Pejës, se Peja në ato kapacitete që i ka, ka bërë mjaftueshëm. Natyrisht mundet ndoshta pak më mirë, po i ka kapacitete të tilla që shumë sende varen nga dora e pushtetit qendrorë. Folëm edhe për te burimi i Drinit ne duhet me e dit që dhe kompetencat atje janë të qeverisë. Kemi pasur rast kur kemi investuar në shtrirjen e rrugës atje, dhe që janë ardh inspektorat shtetërorë që na kanë ndalua edhe që besa e ka denu drejtorinë. Kështu që janë përzierje kompetencash. Lypni raportet tek ata që e kanë kompetencën ndërsa për kompetencat komunale që i ka Drejtoria e Zhvillimit Ekonomik lypni këtu!

Znj. Xhenet Syka Kelmendi: e përcolla debatin me shumë vëmendje dhe nga deformimi profesional mbase e kam se me ka rastisur vitet e fundit te prezentoj jashtëzakonisht shumë në arenën vendore dhe ndërkombëtare. Si asamblistë konsideroj që së paku duhet ta dini planin zhvillimor komunal që është në periudhën master deri në vitin 2028 dhe është dokumenti më i rëndësishëm që e ka shkruar, aprovuar dhe implementon kjo komunë. Në dokumentin më të rëndësishëm të komunës së Pejës, industria më e rëndësishme dhe me prioritetin më të lartë është turizmi i qëndrueshëm dhe agrobujqësia. Dola para jush ta them duke qenë shpesh herë prezantuese e ngjarjeve dhe eventeve te Anibar, te Peja Outdoor Festivali, te panairi veror, te panairi vjeshtor, te rrugë festi, te instituti arkiv mbështeten vetëm me këto forca dhe me këto mundësi financiare që i kemi nga ky pushtet lokal. Çuditërisht të gjithë prirsit politik qoftë të nivelit qendror, qoftë të nivelit lokal, krekosen pafund dhe mezi presin të jenë të ftuar qoftë në hyrjet apo qoftë në mbylljet e këtyre festivaleve në mënyrë që ta ken fjalën e rastit dhe të të kërkojnë infinit që e them unë me të gjithë të arriturat e zhvillimit që janë bërë në Pejë. Kujt i pëlqen ose jo, komuna e Pejës është bartëse e projekteve IPA që janë projekte ndërkombëtare për

zhvillimin e turizmit. Komuna e Pejës është bartëse e vija feratave. Komuna e Pejës është bartëse e vija dinarikës në krejt rrafshin e Dukagjinit dhe komuna e Pejës është bartëse e projektit Majat e Ballkanit. Të gjitha këto janë bërë vetëm me djemt dhe vajzat më të mira që i ka Peja që janë entuziastë. Për këtë arsye duhet patjetër drejtoria të qëndrojë afër organizatave joqeveritare sepse si e vetme nuk mund t'i organizoj këto festivale ndërkombëtare që janë duke organizuar në Pejë. Përpos Prishtinës ku zhvillohet edhe turizmi diplomatik ku zhvillohet edhe jeta konferenciale diplomatike, Peja është vendi më i vizituar nga turistët vendorë dhe ndërkombëtarë edhe me qëndrime ditore edhe me bujtina këtu në Pejë kështu si jemi. Të gjitha këto detaj të mira kështu si bëhen komplet me ndihmën e këtij pushtetit lokal, çfarë është për këtë është dëshmuar dhe një tjetër konsideroj që në jetën politike. Sidomos kush e kupton pushtetin lokal dhe kush ka një eksperiencë në pushtetin lokal nuk ka drejtori të rëndësishme dhe të parëndësishme. Të gjitha drejtoritë janë jashtëzakonisht shumë të rëndësishme për t'i realizuar detyrat dhe shërbimet e veta që i kanë marrë karshi qytetarëve e drejtorët. Nëse shfletoni pak më detajisht dhe pa emocione, Peja është një nga qendrat më të rëndësishme të Ballkanit Perëndimor, në veçanti me promovimin dhe zhvillimin e turizmit të kulturës, shtegut kulturor, por edhe turizmit avanturier. Për sa i përket vërejtjeve të Shabit, plotësisht pajtoj, është një detaj tjetër. Filozofia e menaxhimit të ambientit dhe filozofia e edukatës së njerëzve në menaxhimin e ambientit kujtoj që është përtej pushtetit lokal dhe përtej mundësive që i kemi ne si komunë e Pejës. S'keni të drejtë për ankesë, por të besoni që filozofia e edukimit në ambient është detaj tjetër.

Z.Berat Ganiqi: Nasreti vetëm paska lëviz me j'a kujtu që projektet ndërkufitare mbikëqyen prej qeverisë së Kosovës edhe ka marrë fonde. Me j'a kujtu Nasretit se hiç më larg që javën e kaluar MPL 300.000€ i ka jep grante për turizëm. Me j'a kujtu për çdo rast tjetër që krejt këto fonde i ka marr. Këtu drejtoresha përmendi programet IPA. A e dini prej kujt menaxhohen programet IPA? Prej qeverisë së Kosovës. domethënë nuk e bëjnë, as dallimin kush e udhëheq edhe kush e mbikëqyr buxheti i qeverisë së Kosovës. Krejt këto i kanë marrë prej buxhetit të Kosovës. Projektet ndër kufitarët atje i ke pas prej qeverisë së Kosovës. 300.000€ grant i ke pas javën e kaluar prej MPL-së. A kupton? Te rruga e Rugovës veç të flas për rrugën e Rugovës secili e din farë keqpërdorimi ka ndodhur aty. Ajo kish me vazhdu edhe më shumë me keqpërdorime sikur mos ta kishim ndalu, e mos ta kisha zbulu se fotografitë e Kaçanikut po vijnë në Pejë, si investim prej firmës mafioze e cila është tu investuar atje. Ajo firmë mafioze e them kështu publikisht. Ajo është në prokurori prej meje, edhe në prokurori ka përfundu me aktakuzë, edhe me emër të Zotit edhe ka me u dënu për këtë keqpërdorim. Secili qytetarë të Rugovës këtu i kam kërkuar falje për rrugën të cilën është në gjendje të keqe. Mirëpo cila është përgjegjësia tjetër? Përgjegjësia tjetër është se në atë rrugë keni dashur edhe me investu dhe është prish dhe nuk u kthy siç ka qenë më herët. Domethënë e keni pasur për detyrë me kthy siç ka qenë më herët zhvillimit të turizmit. Ku e ke atë trenin që ju dilshit zhvillim turistik me shku deri te i pesti? Ku është treni? Ku e ke balonën me gaz? Ka e ke zhvillimin e turizmit? Kërkund hiq! Dil me fakte dil sa investimi i ke marrë. Po tha këtu po krekosën. Po edhe kur u qit themeli për këtë qendrën nacionale të xhudos me nxi pritëm me shku me bë foto krah të kryeministrit edhe me j'a lënë diqysh drejtorisë në Pejë që është njëfare investim.

Znj.Hidajete Nikçi: e mora fjalën sepse më nxiti debati paraprak kur është çështja tek rruga, për Rugovë, e dimë shumë mire mburja e cila u bë me rrugën e Peklenes për shkak të një projekti i cili nuk është bërë i mire. Ajo rrugë ka përfunduar deri tek një guri i cili ose tek bjeshka që s'ka mundur me depërtu më shumë. Pse ka ndodhur kjo? Sepse komuna e Pejës nuk e ka bërë planifikimin si duhet dhe tash të gjitha ato duhet qeveria t'i ndaj buxhetin ekstra për shkak të një planifikimi i cili nuk është bërë si duhet ose projektim për këtë rrugë. Ndërsa sa i përket për rrugën tjetër tash i kemi parë dy projektet që ministria po punon ato projekte, edhe do të bëhet më rruga më e mira e cila do të thahet kjo rruga që është adekuate tash.

Z.Naim Bytyqi: e degjova me vëmendje drejtoreshën me të vërtetë kisha pas dëshirë qashtu me qenë. Unë jam duke e pa raportin financiar ku janë hyrat turizmit ato lëvizje a mundesh me mi gjet? S'janë të hyrat jo ato çka vijmë e çka s'vijmë. Po veç kur të folësh diçka duhesh me mbajt me atë fjalë. Nuk mundem me mashtrë qytetarin, turizmi e ka punën keq komunën e Pejës. Sa doni mund me bë politikë. A i ka fajet rruga kryesore, i ka fajet edhe digasteret komunale i kanë. Ama me thënë krejt mirë qysh na bëre ti lula të xhenetit, nuk është, mbase qashtu jemi ardhë deri këtu. Beso kemi has një hendek shumë të madh i thënë qytetarit krejt mirë lula krejt, ata po hasin therra se s'ka lula.

Z.Ardit Gërvalla: drejtoresha është mirë me na kallëzu përpos këtyre festivaleve që po krekoset, kjo këtu në kuvendin komunal, me na kallëzu institucionin më të rëndësishëm të kulturës në Pejë, teatrin e qytetit, pse nuk e ka funksionalizuar edhe pse e ka paraparë deri në vitin 2027 ky projekt me përfundë dhe me u funksionalizë. Ku e ke teatrin drejtoreshë?

16.Shqyrtimi i raportit (informatës) rreth aktiviteteve të KKSB-së.

Znj.Hidajete Nikçi: Sa i përket takimeve që janë mbajtur të KKSB-së, kam një pyetje në lidhje me këto takime. A u diskutuar ndonjëherë për sigurinë e fëmijëve që dalin për t' ushqyer jashtë shkollë? Po flas konkretisht për shkollën "8 marsi", nxënësit të cilët dalin në pushime të gjata frekuentojnë rrugën Kuvendi i Lezhës dhe gjatë frekuentimit në grupe pengojnë komunitetin duke goditur nëpër dyert e tyre. Po ashtu në vrapimet të cilat i bëjnë gjatë ikjes së tyre ato paraqesin edhe mos siguri për ta!

Nënkryetari Fatmir Asllani: nesër e kemi edhe takimin e tretë sa i përket përmbushjes së planit për gjashtë muhorin e parë të vitit 2026. Ndërsa sa i përket pyetjes së Hidajetes, ne kemi diskutuar për ushqimet dhe për lëvizjet e nxënësive. Për detaje që e potencove nuk e kemi diskutuar at detaj, se nuk e kemi pas si informatë. Ne si pjesë e ekzekutivit gjithmonë jemi mundu që fëmijëve me ju lënë sa më shumë afër shkollave, me mujt me ble diçka ata që kanë nevojë me ble. Tash ne e kemi pas edhe anën tjetër kritike që kemi jep hapësira shkollore për me bë shitjen e këtyre sendeve. Po ideja e vetme ka qenë që fëmijët mos me dalë jashtë oborrit të shkollës. I kemi diskutu dhe edhe me drejtorin i cili është prezent çdo takim me KKSB-në, por dhe me përfaqësuesit e prindërve që janë anëtarë të Këshillit Komunal për Sigurinë në Bashkësi.

Kryesusi Rexhep Kurtbogaj: unë e kisha përmend një temë që është goxha preokupuese për qytetarët sidomos të zonës urbane që jetojnë. Kishte me qen mirë që të jetë pjesë e diskutimeve

në komitet në Këshillin për Siguri në bashkësi. Janë lëvizja e shpejtë e kereve në orë të vona të natës edhe gjatë ditës tash. Me ardhjen edhe të diasporës edhe komunikacionit të ngarkuar shumë ankesa ka për zërin e motorristave dhe kerrave që po i traumatizojnë në mbrëmje kur jepen ngaz. Ish kanë mirë që me me fitu një partnerite me policinë sidomos gjatë kësaj sezone në orët e vona të natës me dalë e me i patrollu .

Nënkryetari Fatmir Asllani: nesër do ta diskutojmë këtë pyetje që e parashtrove ose si shqetësim. Po i kemi diskutuar edhe më herët, po nesër sigurisht edhe komandanti i policisë është prezent edhe do të do ta parashtrojmë këtë shqetësim të do ta çojmë deri në Këshill Komunal për Siguri në Bashkësi.

17.Pyetjet dhe propozimet lidhur me punën e Komunës, të ngritura nga anëtarët, në atë rënditje siç jan pranuar:

Nuk ka pasur.

18.Çështje të ngritura në mbledhje nga udhëheqësi apo nga anëtarët e Kuvendit.

Z.Drin Veselaj: deshta me pyet për një vendim që e ka kthyer MAPL-ja që ne s'e kemi pare, a ka mundësi me dit çfarë përgjigje ka kthyer për përzgjedhjen e zëvendës kryesuesit, edhe çka? Pse ne s'e kemi parë vendim kisha pas dëshirë veç me dit a u kthyer një vendim edhe çfarë vendimi ka qenë ai? Se për një mend edhe mundem me gabu, se unë s'jam jurist.

Z.Ardit Berisha: atëherë po e shfrytëzoj rastin çështjet të ndryshme ta ngris çështjen të cilën e propozova dhe në fillim të seancës sot për dijeninë e gjithë anëtarëve të kuvendit komunal, Lëvizja Vetëvendosje me datën 6 maj ka bërë një kërkesë me shkrim për subvencionimin e litres së qumështit për fermerët tanë. Materiali është dërguar, është me arsyetim edhe me gjithë kërkesën tonë të cilën ne e kemi parashtruar. Me datën 15 maj kemi fillu një nismë për mbledhjen e nënshkrimeve për seancën të jashtëzakonshme. Ku ne si parti opozitare i kemi dhënë të gjitha nënshkrimet për thirrjen e kësaj seance të jashtëzakonshme, ndërsa as pozitë dhe as opozitë, asnjë anëtar i kuvendit komunal nuk është përgjigj thirrjes tonë për këtë seancë të jashtëzakonshme. Në seancën e 29 majit në Kuvend komunal kam propozuar për herë të parë të futen si pikë të rendit të ditës çështjen e gjendjen e fermerëve të komunës së Pejës. Po ashtu edhe shqyrtimi i propozimit tim për mbështetjen e fermerëve tanë, nuk është marrë parasysh. Me 17 qershor në KPF, kam propozu kjo çështje dhe kjo pikë e rendit dites të hyjë sot në këtë seancë andaj si duket kjo çështje nuk ka ardhur si propozim dhe kryesuesi nuk e ka futur si pikë e rendit të ditës. Edhe sot me datën 29 qershor, prap propozova që kjo çështje të ngritet në këtë kuvend komunal, për shkak që mendoj që kuvendi komunal është organi më i lartë i komunës edhe i takon që të diskutojë propozimet të cilat edhe opozita i bën, e që ky propozim normalisht ka ardhë si pasoj për shkak se fermerët e qytetit tanë çdo ditë na kontaktojnë, por besoj që dhe juve si anëtarë të kuvendit komunal si qoftë opozitë, si qoftë pozitë ju kontaktojnë. Gjendja e tyre është e keqe, është alarmante. Shumë fermerë shembull vetëm të Lugut të Baranit më kanë kontaktuar dhe kanë thënë që janë në prag të falimentimit. Pra nëse ka njerëz të cilët ja blejnë gjedhet e tyre, ata janë të gatshëm sot me me i shit. Ndërsa këto subvencione të cilat po jep komuna Pejës, nuk e di a do të munden t'i shfrytëzojnë ato mjete nëse këta fermerët tanë e

falimentojne. Ne e dimë që te subvencionimi i litrës së qumështit aty nuk ka hise të kërkujt. E ndoshta kjo është arsyeja apo një ndër arsye sepse nuk po përkrahet kjo ndarje e 0.10 cent për liter të qumështit. Ka ankesa nga fermerët të cilët tash tre muaj nuk i kanë marrë parët e tyre edhe pse e kanë dorëzuar qumështin. Andaj përmes foltores së këtij kuvendit e bëj thirrje edhe grumbulluesit e qumështit Rugova dhe Vita të cilët nuk i kanë bërë pagesat për litrat e qumështit të përgjigjen fermerëve tanë t'ju ndihmojnë në këtë periudhë. Po ashtu ne edhe sot publikisht e them që do të fillojmë procedurën për mbledhjen e një seance të tjetër të jashtëzakonshme. Andaj i bëj thirrje edhe opozitës, pra AAK-se dhe pse nuk janë këtu fizikisht në mbledhje që të na japin nënshkrimet e tyre dhe bashkarisht të thërrasim një seancë të jashtëzakonshme, të diskutojmë këtë çështje po ashtu të shohim edhe mundësinë e ndarjes buxhetore kudo që mundemi një fond emergjent nga buxheti i komunës të ndahet që t' dalim në ndihmë fermerëve tanë.

Znj.Gentiana Bajrami Atashi: dëshiroj të ngris një çështje që ka të bëjë me përmirësimin e kushteve infrastrukturore në shkollën fillore të mesme Xhemajl Kada. Ne e dimë që është investuar në këtë shkollë pasi që kam qenë edhe mësimdhënëse në atë shkollë, por besoj që duhet të ngrihen edhe disa çështje që kanë të bëjnë me infrastrukturën në këtë shkollë. Si prioritet kryesor besoj që duhet të jetë investimi në rrethoje në pjesën perëndimore të kësaj shkolle, e cila ka të bëjë me cënimin e sigurisë për nxënësit dhe mësimdhënësit e kësaj shkolle, sepse aty po mundësohet hyrja dhe lëvizja e personave të paautorizuar dhe kërkoj që kjo ndërhyrje të jetë e domosdoshme dhe të realizohet këtë vit nëse është e mundur . Po ashtu prioritetet të tjera janë edhe ndërrimi i dyshemë së kësaj shkolle dhe gjithashtu ndërrimi i dyerve të cilat tashmë janë të dëmtuara dhe besoj që janë të rëndësishme që të investohet në këto dy prioritetet për shkak që të ndikohet në zhvillimin më cilësor të procesit mësimor. Besoj që investimi në infrastrukturën e shkollave duhet të jetë prioritet dhe shpresoj që Drejtoria për Arsim dhe akterët e tjerë të kenë këto dy prioritetet si kërkesë dhe të trajtohen për në përfshirjen e planit të investimeve. Pra rrethoja e shkollës për këtë vit, ndërsa dyert dhe dyshemeja së paku të investohen në vitin e ardhshëm.


Z.Naser Gega: e kem prioritet Xhemal Kadën gjithsesi, por këtë vit investimet për dysheme, dritare, të tjerat janë parapa për shkollën Dardania, për shkollën e Dardanisë paralel e ndam Poqeste, është e parapar me një palestra në Tresenik, të shohim me shkollën e Lozhanit. Për vitin e ardhshëm synojmë që në plan të parë ta vendosim shkollën Xhemal Kada, sepse ka nxënës shumë paralelisht është duke u ndërtuar edhe shkolla poshtë atje, po të shpresojmë që do të jemi në rregull me financa dhe shkollën Xhemal Kada ta vendosim me prioritet të lartë dhe këtë qëllim e kemi besoj se vitin e ardhshëm.s

Meqë u shqyrtuan të gjitha pikat e rendit të ditës e propozime tjera nuk ka pasur, kryesuesi z. Rexhep Kurtbogaj e shpalli të mbyllur këtë takim të kuvendit, në orën 13:40 h.

Video incizimi i këtij takimi të Kuvendit të Komunës së Pejës në kanalin zyrtarë në Youtube.

Kliko: <https://www.youtube.com/watch?v=EO8bnfwDgtg&t=3787s>

Procesmbajtësja,
znj. Donjeta Morina



KRYESUES I KUVENDI,
z. Rexhep Kurtbogaj

